



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.43/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], me adresë [REDAKTUAR], Gjermani, e parashtruar ndaj KQZ-së, për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 20.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.A.nr.43/2025 e parashtruar nga [REDAKTUAR] me adresë [REDAKTUAR] Gjermani, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 17.09.2025, PZAP-i, përmes e-mail adresës zyrtare ka pranuar ankesën ZL.A.nr.43/2025 nga [REDAKTUAR], me vendbanim në Gjermani, në të cilën ka theksuar se, me datë 27.07.2025 ka aplikuar si votuese për zgjedhjet lokale dhe me datë 28.07.2025, KQZ ka pranuar pjesëmarrjen e së njëjtës në zgjedhje lokale. Ndërsa, me datë 31.08.2025, një ditë pas mbarimit të regjistrimit të afatit të rregullt, pa pasur mundësi të ndryshoj asgjë, KQZ ka anuluar aplikimin dhe ka njoftuar për të drejtën e ankesës deri me 30.09.2025, duke bërë që afati i ankesës të ketë përfunduar një ditë para ardhjes së e-mail-it, pra KQZ po shkon një ditë mbrapa në kohë. Tutje, ka theksuar se e-mail i dhënë është i djalit të ankueses sepse nuk ka email personal.

Parashtruesja e ankesës si provë ka bashkangjitur: emailin e datës 27.07.2025 me të cilën konfirmohet pranimi i kërkesës për regjistrim, atë të datës 28.05.2025 përmes të cilit është miratuar kërkesa për regjistrim, emailin e datës 31.08.2025 me të cilën i është anuluar aplikimi për regjistrim dhe njoftimi për të drejtë të ankesës deri me datë 30.08.2025, si dhe letërnjoftimin.

Në përgjigje në kërkesë KQZ lidhur me ankesën ZL.A.nr.43/2025 ka deklaruar se afati i ankesave ka përfunduar me datën 5 shtator 2025, ndërsa KQZ ka certifikuar listën votuese brenda dhe jashtë Kosovës me datën 6 shtator 2025. Gjithashtu parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur kundërshtim administrativ brenda KQZ-së. Shtetasja [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i

ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDACTED], ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes email-it, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimtë për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar, e-mail adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të email-it dhe numrin personal të telefonit mobil. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia- PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, pasi që parashtrësia e ankesës gjatë aplikimit të saj për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *"4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1..."*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se parashtrësia e ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nga verifikimi dëshmisë paneli vëren se e-mail adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votueses, pra nuk është adresë personale, dhe si e tillë është në kundërshtim me nën paragrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të email-it dhe numrin personal të telefonit mobil, ndërsa, parashtrësia e ankesës aplikimin e ka bërë përmes e-mail adresës së familjarit të saj [REDACTED] dhe e njëjta nuk është në përputhje me emrin personal të ankueses.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe pretendimeve ankimore, PZAP vlerëson se, në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankueses, andaj pretendimet e ankueses nuk i aprovoi si të bazuara, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga KQZ-së.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesja e ankesës, nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresën personale të email-it dhe numrin personal të telefonit mobil, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nen 3 paragrafi 5 pika 5.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 5 pika 5.1 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr. 43/2025 datë 20.09.2025

Kryesuese e Panelit

Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.